



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA FUSHË-ARRËZ
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 662 prot.

Fushë-Arrëz, më 04 . 03 . 2025

VENDIM

Nr. 7, datë 28. 02. 2025

PËR

MIRATIMIN E LISTËS SË PËRFITUESVE TË NDIHMËS EKONOMIKE NGA FONDI I KUSHTËZUAR I BLOK-NDIHMËS EKONOMIKE PREJ 6% PËR MUAJIN JANAR 2025 PËR NJËSITË ADMINISTRATIVE : FUSHË-ARRËZ, IBALLE, QAFË-MALI , BLERIM DHE FIERZË.

Në zbatim të ligjit 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore:”, i ndryshuar, neni 24, ligjit nr, 57/2019 ”Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë”; VKM nr.597.datë 4.9.2019 “Për përcaktimin e procedurave të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe të përdorimit të fondit shtesë, mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike”, VKM nr.85, datë 10.02.2021 “Për një shtesë në vendimin nr. 597. datë 4.9.2019 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e procedurave, dokumentacionit dhe masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike, dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike”; Udhëzimit të Ministrisë së Mirëqënies Sociale dhe Rinisë nr. 5, datë 17.2.2017 ”Për përdorimin e fondit të kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike deri në 6%”, i ndryshuar ; VKM nr.868. datë 29.12. 2021 “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr 597. datë 4.9.2019 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e procedurave, dokumentacionit dhe masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe të përdorimit të fondit shtesë mbi fondet e kushtëzuara për ndihmën ekonomike”,VKB nr.2, datë 27.01.2025 “Për miratimin e kriterëve të dhënies së ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar i bllok-ndihmës ekonomike deri në 6%”, **Këshilli i Bashkisë Fushë-Arrëz në mbledhjen e tij të datës 28.02.2025**, pas shqyrtimit të propozimeve të paraqitura nga administratorët e ndihmës ekonomike të bashkisë Fushë-Arrëz:

VENDOSI

Të miratojë listën e përfituesve të ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar i bllok- ndihmës ekonomike deri në 6 % për muajin **Janar 2025** me **32** familje, dhe fond **125,275** lekë nga fondi total i ndihmës ekonomike në vlerën **2,087,933** lekë dhe shpërndarë për përfituesit e 6% në Shumën **120,390** lekë të shpërndarë sipas Njësive Administrative:

NJËSIA ADMINISTRATIVE QENDËR FUSHË-ARRËZ

Përfitojnë ndihmë ekonomike të plotë nga fondi i kushtëzuar i bllok-ndihmës ekonomike i 6% për muajin **Janar 2025**, 17 familje me një fond **61,487** lekë.

NJËSIA ADMINISTRATIVE IBALLE

Përfitojnë ndihmë ekonomike të plotë nga fondi i kushtëzuar i bllok-ndihmës ekonomike i 6% për muajin **Janar 2025**, 5 familje me një fond **20,136** lekë.

NJËSIA ADMINISTRATIVE FIERZË

Përfitojnë ndihmë ekonomike të plotë nga fondi i kushtëzuar i bllok-ndihmës ekonomike i 6% për muajin **Janar 2025**, 2 familje me një fond prej **6,752** lekë.

NJËSIA ADMINISTRATIVE QAFË-MALI

Përfitojnë ndihmë ekonomike të plotë nga fondi i kushtëzuar i bllok -ndihmës ekonomike i 6% për muajin **Janar 2025**, 4 familje me një fond **13,999** lekë.

NJËSIA ADMINISTRATIVE BLERIM

Përfitojnë ndihmë ekonomike të plotë nga fondi i kushtëzuar i bllok-ndihmës ekonomike i 6% për muajin **Janar 2025**, 4 familje me një fond **18,016** lekë.

Bashkëlidhur tabelat e detajuara për çdo Njësi Administrative të bashkisë Fushë-Arrëz.

Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Administrata e Bashkisë.

Vendimi u miratua nga Këshilli Bashkiak me:

11 vota pro


0 vota kundër

0 vota abstenim

Zbardhur, më 04. 03. 2025.

SEKRETAR

Naze SELIMAJ



KRYETAR

Nikolin BARDHOKU

